



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 45
Prishtinë, më 29.9.2016, orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Emilija Rexhepi, Sërgjan Popoviq, Salih Salihu, Haxhi Shala dhe Shaip Muja.

Mungoi: përfaqësuesi i AAK-së.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë, sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 9.8.2016 dhe 14.9.2016;**
- 3. Shqyrtimi i çështjes së banorëve të zhvendosur të fshatit Hade;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 9.8.2016 dhe 14.9.2016

Procesverbalet e mbledhjeve të datës 9.8.2016 dhe 14.9.2016 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i çështjes së banorëve të zhvendosur të fshatit Hade

Duda Balje, kryetare, falënderoi pjesëmarrësit, z. Arben Çitaku, sekretar i MMPH-së, z. Xhafer Gashi, kryetar i Komunës së Obiliqit, z. Hilmi Jashari, avokat i Popullit, z. Arben Gjukaj, drejtor i KEK-ut, përfaqësuesin e MZHE-së, znj. Dajana Berisha, drejtoreshë e Forumit për Iniciativë Qytetare (FIQ) dhe banorë të fshatit Hade.

Ajo tha se pas vizitës që bashkë me anëtarët e Komisionit kemi bërë në terren, mendojmë se gjendja atje është alarmante dhe të gjitha institucionet nuk duhet të jenë pasive në kërkimin e mundësive për zgjidhjen këtij problemi. Pasi që kemi marrë disa propozime në lidhje me këtë problematikë nga organizata FIQ, ne kemi tentuar të bëjmë një rezolutë që ta dërgojmë pastaj në Kuvend. Prandaj sot kërkoj nga anëtarët e Komisionit që parashtrojnë pyetje konkrete në lidhje me këto propozime. Gjithashtu nëse kompetencat në mes dy ministrive, MMPH-së dhe MZHE-s janë të përziera në lidhje me këtë, propozoi që pyetjet të bëhen në këtë drejtim, rreth zgjidhjes së problemit të zhvendosjes së banorëve të fshatit Hade.

Ajo parashtoi pyetjen për MMPH-në, se cilat janë kompetencat e juaja në lidhje me zhvendosjen dhe gjithçka që po ndodh atje në terren?

Arben Çitaku: Kompetencat e MMPH-së janë të qarta në raport me zhvendosjen. Ne e bëjmë monitorimin e dokumentit që quhet “korniza e politikave të zhvendosjes” dhe që këtë dokument obligohen kompanitë, në këtë rast KEK-u, që ta zbatojë. Ndërsa në kontekstin e ndërtimeve, kompetencat janë shumë të qarta në bazë të ligjit të ndërtimit për nivelin qendror dhe lokal. Në rastin konkret, kur është në pyetje fusha e mihjes së re, ne e përkrahim Komunën e Obiliqit në këshillat që këta mund t’i kërkojnë nga MMPH. Në rastin kur komuna dhe KEK nuk kanë mundësi që t’i dërgojnë përpara çështjet, atëherë i drejtohen Qeverisë dhe pas autorizimeve të Qeverisë MMPH-ja është e gatshme të futet në proces.

Duda Balje pyeti: A ka evidenca të sakta sa shtëpi kanë ekzistuar në Hade dhe Shipitullë deri në vitin 2013? A ka evidencë për shtëpitë e dëmtuara nga rrëshqitja, prej zgjatjes së zhvendosjes në kohë?

Arben Çitaku u përgjigj se nuk është kompetencë e departamentit të shpronësimit kjo, ndonëse ne kemi evidenca. Mirëpo kompania që është angazhuar nga KEK-u për ta bërë vlerësimin e këtyre i ka të gjitha këto shënime. Në bazë të shënimeve të departamentit

shtëpi të dëmtuara nga zhvendosja apo rrëshqitja nuk kemi, kemi shtëpi të dëmtuara nga lufta.

Shaip Muja- Tha se është mirë me marrë një qëndrim pragmatist për zgjidhjen e problemit. Ne, si parlamentarë, mund të rekomandojmë në një seancë plenare që 150 shtëpia, të cilat janë të rrezikuara edhe nga çështja e ambientit e zhurmës, të zhvendosen në vendin e planifikuar për banim në Shkabaj dhe të gjendet një mundësi e donatorëve që t'ju ndërtohet atyre 150 shtëpitë, ose në bashkëpunim me MZHE të zgjidhet situata. Në rast se KEK-u e vazhdon me planin e shfrytëzimit të atyre tokave deri në vitin 2024, në momentin kur i fut në plan për eksploatim banorëve t'iu eksproprijohen dhe t'iu paguhen, e këta deri në atë kohë janë pronarë të shtëpive dhe tokës. Në bazë të ligjeve, atyre banorëve duhet t'u garantohet e drejta për jetë dhe kontaminimit që ata i ekspozohen nga ndotjet e ndryshme është e pa tolerueshme, sepse është shkelje e të drejtave të njeriut.

Adem Salihaj në fillim tha se këtu pjesëmarrësit nga dy ministritë janë nga shërbimi civil me të cilët nuk komunikojnë Kuvendi, por me nivelin politik. Sekretarët e përhershëm për të cilët kemi respekt, nuk janë personat kompetentë që mund ta japin një zotim për zgjidhje. Nxjerrja eventuale e një rezolute nga Komisioni, duhet pasur të qartë se Rezoluta nuk është e obligueshme të zbatohet nga qeveria dhe nuk do ta zgjidhim problemin. Qeveria a mund ta bëjë një plan veprimi, p.sh. brenda 1 muaji për pjesën e mbetur të Hades, ndryshe nuk mund të bëjmë asgjë. Një pjesë e Hades është zhvendosur, një pjesë e tokave u janë marrë, një pjesë tjetër janë aty, ndoshta gjysma, tokat prej të cilave kanë jetuar nuk i kanë, mihja është sjellë në tri anë dhe ata kanë mbetur aty. Nuk u lejohej të ndërtojnë shtëpi, as nuk i kanë tokat për sigurimin e jetës dhe as nuk e kanë mundësinë të zhvendosen diku tjetër. Ky është një problem shumë serioz, që do qasje serioze dhe duhet të gjejmë zgjidhje për këtë. Zgjidhja kërkon mjete financiare të cilat duhet t'i sigurojë dikush dhe ne nuk mund ta bëjmë një zgjidhje serioze pa marrë një konfirmim që këto mjete do të sigurohen. Në Shipitullë është një vijë kufizuese jashtë të cilës nuk ka qymyr, ndërsa ata do të zhvendosen edhe pse nuk do të shkohet me mihje andej, pastaj ka edhe ndërtime të reja që janë bërë aty kohëve të fundit dhe për çudi në Hade. Para se të nxjerrim një rezolutë ose një vendim si Komision bashkë me ministritë përkatëse dhe banorët duhet t'i shqyrtojmë mirë të gjitha mundësitë dhe vendimi të jetë në funksion të zgjidhjes së problemit. Ministritë duhet të na japin një përgjigje, a mund ta zgjidhim dhe si mund ta zgjidhim këtë problem dhe një afat kohor. Nëse ministritë na thonë se nuk kanë mjete për ta zgjidhur dhe se kushton 120 milionë euro, atëherë ne duhet të diskutojmë se çfarë zgjidhje tjetër të bëjmë.

Duda Balje i shtroi pyetje për KEK-un, nëse ka mundësi të na thoni sa mjete kërkohen për këtë?

Arben Gjuka: Ne, si operatorë, kemi planin e zhvillimit të minierës dhe aktiviteteve deri në vitin 2024 dhe vlerësimi për fshatin Shipitullë e cila i ka 3 lagje: Krasniqi, Mirena dhe Berbatovci. Kosto e zhvendosjes, në bazë të kompanisë për vlerësim për shkak të ndërtimeve ilegale dhe veprimeve ilegale në kundërshtim me ligjin nga 4.5 milionë ka kaluar në 13 milionë. Ndërsa në bazë të vlerësimeve tona nga e kaluara që kemi paguar në vitin 2009 për lagjen Shala të fshatit Hade, kostoja pritet të jetë diku afër 25 milionë euro. Ne, si kompani, kemi filluar aktivitetet për ta bërë një studim fizibiliteti, i cili do të japë etapat ku secili fshat e ka kohën e zhvendosjes dhe kostoja e saj, sekretari tha se është në vlerë prej 120 milionë euro.

Shaip Muja shtoi se obligimi ynë, si deputetë, është të konkludojmë se, a po shkelen ligjet që janë në fuqi? Konkretisht ligji për të drejtat e njeriut dhe ligjet e ambientit. Komuna nuk mundet me planifikuar atje asgjë, infrastrukturë, etj.

Hilmi Jashari, Avokati i Popullit, tha se është e padiskutueshme se ka probleme dhe ka plane, por pyetja kyçe është: cili ligj është duke u zbatuar? Nuk është çështje e vullneteve këtu, sepse secili që diskuton në bazën e vullneteve ia kemi huq shumë rëndë objektivit kryesor që është zbatimi i ligjshmërisë. Kemi një varg të drejtash nga Kushtetuta që i obligojnë edhe qytetarët edhe autoritetet publike. Është ligji për shpronësimin i cili ka përcaktuar hapat cilat duhet ndjekur nga organi shpronësues. Nëse organi shpronësues nuk e zbaton ligjin, cila është përgjegjësia e tij dhe ligji përcakton drejt cilat janë të drejtat, pra cilat janë drejtat që janë shkelur në këtë rast?

Murat Hoxha, parashtrori 3 pyetje: cila ka qenë baza ligjore fillestare nga viti 2004 që ka filluar eksproprijimi apo zhvendosja? A ekziston tani baza e mjaftueshme ligjore dhe kush janë përgjegjësit për me i zbatuar këto ligje?

Arben Çitaku: Për sqarim ftesa i është dërguar sekretarit, e jo ministrit dhe me kënaqësi ministri do të ishte këtu. Ndërsa në përgjigjen në pyetjet tha: Ne kemi bërë një vlerësim të përafërt të shumës e cila do të ishte deri në vitin 2033. Në kuadër të kompetencave MMPH, në bazë të ligjit për planifikim hapësinor ne kemi qenë të obliguar të bëjmë planin hapësinor për atë zonë. Ne jemi përgjegjës për kontrollin e kualitetit të jetës së përmes ligjeve të mjedisit. Jemi përgjegjës për ligjin e shpronësimit dhe në përputhje me ligjin e shpronësimit dhe standardeve më të mira ndërkombëtare e kemi hartuar “*Kornizën e politikave të zhvendosjes*” si dokument i cili duhet zbatohet në këtë rast. Në përputhje me obligimet për me gjetur lokacionin i cili është në Shkabaj që i mbulon pjesën dërmuese të familjeve dhe MMPH-ja këtu i ka kryer obligimet e veta. Mbetet në planet e KEK-ut që do mi zhvilluar mihjet në përputhje me këtë plan hapësinor, në harmoni me kornizën e politikave të zhvendosjes të fillojë procesin e zhvendosjes. Mirëpo ai shtoi se mbetet jashtë kompetencave të KEK-ut sigurimi i buxhetit, pra nëse KEK nuk ka mundësi të sigurojë këto mjete atëherë na mbetet neve si institucione të përbashkëta sigurimi i tyre.

Përfaqësuesi e MZHE-së tha se harton strategjinë për miniera dhe për energji, pjesa që ka të bëjë me obligimet e ministrisë kryesisht ka të bëjë me ndërmarrjen publike. Në këtë rast që operohet nga bordi i KEK-ut dhe menaxhmenti i KEK dhe ne jemi pjesë e ndihmës që kërkohet nga ana institucionale për procedurat në bazë të ligjit për ndërmarrjet publike. Për të gjitha këto kemi qenë në koordinim me KEK-un, edhe planet për zhvendosje janë të koordinuara me MZHE-në. Në këtë rast MZHE është monitoruese e gjithë procesit. KEK ka 1/3 e buxhetit për studimin e fizibilitetit, ndërsa MZHE-ja është duke punuar në gjetjen e mjeteve të tjera, që kushton rreth 2 milionë euro, d.m.th. 1.5 milion të sigurohen nga ana e MZHE-së.

Dajana Berisha, nga FIQ, tha se pajtohem me atë se qasja duhet me qenë pragmatike. Mirëpo nuk shoh një mundësi koordinimi ne mes institucioneve dhe nëse keni nevojë, ne si FIQ do të japim një kontribut në koordinimin mes ministrive. Problemi qëndron te studimi i fizibilitetit dhe te buxheti. Pastaj ajo shtroi dy pyetje:

Për MZHE-në, çka do të përfshinë studimi i fizibilitetit dhe cili është raporti i këtij studimi me zhvendosjen e banorëve. Nëse është studimi për çështjen e shtrirjes së mihjes, mirëpo cila është lidhja me zhvendosjen dhe kush e ka përgjegjësinë ligjore për realizimin e këtij studimi?

Ndërsa për MMPH-në, cili prej dokumenteve ligjore prevalon në raportin e zhvendosjes, ligji për shpronësim apo korniza e zhvendosjes, me cilin jeni duke funksionuar?

Arben Çitaku: Ligji për shpronësim i cakton procedurat, ndërsa korniza e politikave të zhvendosjes i ngërthen standardet dhe gjithherë standardet që duhet të respektohen në raport me qytetarin, janë para ligjit të shpronësimit. Pra, korniza e politikave të zhvendosjes ka vendosur një standard të kualitetit të jetës dhe mënyrës së zhvendosjes së popullatës duke respektuar të gjitha të drejtat e tyre, ndërsa ligji i shpronësimit nuk i mban këto.

Dajana Berisha pyeti, nëse kjo kornizë politike vjen në mungesë të njëfarë standardi brenda ligjit? Pra, ligji është i mangët dhe si rrjedhojë korniza është në funksion të plotësimit të ligjit dhe për ta bërë më funksional.

Arben Çitaku u përgjigj se ligji është në proces, në rishkim është në strategji legislative. Mirëpo të gjitha vendet edhe procedurat e Bankës Botërore e nënkuptojnë një standard të zhvendosjes që ne e kemi adoptuar si kornizë e politikave të zhvendosjes, si qeveri dhe e kemi futur në funksion përmes një vendimi qeveritar.

Arben Gjuka tha se aplikimi i kornizës vjen me insistimin e Bankës Botërore, e KEK-u gjithherë e ka refuzuar dhe ka thënë se ne duam ta zbatojmë ligjin, për shkak se Kosova është Republikë Parlamentare, dhe ligji është mbi çdo kornizë ose udhëzim administrativ tjetër.

Hilmi Jashari tha se duhet të sqarojmë se ky dokument “korniza e politikave të zhvendosjes për zonën fusha e mihjes së re e përcaktuar me vendimin e qeverisë përkufizon politikat e qeverisë lidhur me zhvendosjen e popullatës. Prandaj ky nuk e ka as fuqinë e një vendimi dhe asnjë vendim nuk e ka fuqinë më të madhe se ligji që e ka miratuar Kuvendi.

Adem Salihaj shtoi se s’jemi afër zgjidhjes së problemit, së pari nuk e kemi një vendim se do të bëhet zhvendosja e kësaj pjese të mbetur. Prandaj s’ka pse merret ministria me shpronësim kur s’ka vendim për zhvendosje, pra është absurde kjo.

Xhafer Gashi, sipas informatave që i kemi Hade është dashtë të zhvendoset në 2012 dhe nuk ka ndodhur. Hade e re e pamë në terren se në çfarë gjendje është. Hade ka mbetur si oazë, ka familje që dëshirojnë të zgjerohen dhe kanë problem për vend. Kemi problem me pjesën që nuk kanë mu zhvendosur deri më 2024 dhe çfarë do të bëjmë me ata t’ju ofrojmë mundësinë të zhvillohen në fshatin e tyre apo me alternativa tjera. Nuk e dimë se kthehet ndonjë projekt nga tantiema për banorët, sipas rregullores për komunitetin. Hade dhe fshatrat përreth janë të atakuar nga probleme të shumta mjedisore, ndotja e ajrit, mbeturinat, zhurma e fenoli. Pra, çdo ligj i mjedisit është i shkelur në Obiliq. Kërkojmë që në zonat ku nuk ka zhvillime minerare në 5 vjetët e ardhme qytetarët të kenë mundësi të zhvillimit, si parcializim, fermë, të bëjnë një jetë normale.

Banorët e fshatit: Ne nuk po kërkojmë diçka të paarrtshme dhe askush përgjegjësinë nuk po e merr, as MZHE, MMPH, KEK e as Komuna. Shtoi se prej 2004 kemi vendime, na kanë premtuar me i marrë tokat, me u zhvilluar mihja, dhe ne i kemi dhënë dhe tash ju thoni se deri më 2024.

Salih Salihu shtoi se posa e parashtrroi një pyetje parlamentare në seancë plenare për kryeministrin rreth Hades dhe pyetja kryesore ishte se pse është devijuar nga plani fillestar me mihje dhe kryeministri tha se nuk jam i informuar për këtë se ka devijuar ai plan. Mua më intereson fillimisht a ka pasur devijim të planit fillestar që është bërë dhe në marrëveshjen që e keni pasur fillimisht me Haden, ka qenë planifikuar komplet Hade

me u zhvendosur, pse ma vonë ka ndryshuar ky plan? Cilat janë qëllimet dhe arsyet që ka devijuar ky plan?

Arben Gjukaj u përgjigj se nuk ka devijim të planit.

Duda Balje tha se nëse bëjmë rezolutën dhe nëse kërkojmë zgjidhje të këtij problemi, ne duhet të jemi të qartë se në çka duhet të bazohemi në ligj apo kornizë dhe ligji juridikisht është më i fortë. Duhet të evidentohet se çka nuk është respektuar nga ligji, sa i përket mjeteve financiare Komisioni duhet të ketë informata të sakta: sa shtëpi ka, sa shtëpi janë ndërtuar deri më 2013, kush janë pronarët e tyre, si kanë marrë lejet për ndërtim, kush është përgjegjës për këtë? Pra, ne duhet t'i japim përgjigje këtyre pyetjeve.

Kryetarja duke i falënderuar pjesëmarrësit për kontributin, tha se ne do të takohemi si Komision përsëri për të vendosur se për diçka konkrete.

5.Të ndryshme.

Kryesuesja e njoftoi Komisionin se nesër, më 30.9.2016, në orën 10:00 në sallën N-302, fillon intervistimi i kandidatëve për zëvendës drejtor në ARRU dhe kryesues të Komisionit Shqyrtues.

- Grupi punues për performancën energjetike shtyhet për të hënë,
- Sugjerimi i drejtorit të ARRU-së për një vizitë në Bullgari rreth punës së rregullatorit të ujërave atje, është që financimi për këtë vizitë vlen për 5 apo 6 anëtarë të Komisionit, bashkë me stafin (mëditjet, vizat dhe transporti me automjet nga Kuvendi, kurse shpenzimet e qëndrimit nga ARRU-ja).

Disa deputetë sugjeruan nga një anëtar nga grupet parlamentare, kurse stafi njoftoi se shpejt duhet të dërgohet shkresa në ARRU-së për periudhën e gjysmës së dytë të tetorit ose në fillim të nëntorit, ngase duhet të bëhen përgatitjet.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje